



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 2595/prot.

Elbasan, më 17.11.2025

3

VENDIM

Nr. 71 datë 17.11.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK NR. 17, DATË
22.07.2021, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROGRAMIT TE STUDIMIT
"DOKTORATË NË SHKENCAT MJEKËSORE TEKNIKE"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, Statutit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", neni 9, me propozim të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, Vendim i Dekanatit të FSHMT Nr.1 datë 20.10.2025 "Për miratimin e Vendimit Nr.11 datë 17.10.2025 të Kolegjit Doktorat "Për propozimin për disa ndryshime në Rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në "Shkencat Mjekësore Teknike". përcjellë me shkresën nr. 386 prot. datë 21.10.2025 "Përcjellje dokumentacioni", Senati Akademik

VENDOSI:

1. Miratimin e propozimit të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike për disa ndryshime në Rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në "Shkencat Mjekësore Teknike".
2. Në Vendimin e Senatit Akademik nr. 17 datë 22.07.2021 për miratimin e rregullores së programit të studimit "Doktoratë në Shkencat Mjekësore Teknike", bëhen disa ndryshime, në përputhje me propozimin e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, sipas teksit që i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Elvira Fetahu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

Për disa ndryshime në Rregulloren 'Për organizimin dhe funksionimin e programit të studimit të ciklit të tretë – Doktoratë në 'Shkencat Mjekësore Teknike''

Neni 1 (ishte)

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të programit të studimit të ciklit të tretë, "Doktoratë në Shkencat Mjekësore Teknike" (ishte);

Neni 1 (bëhet)

- 1.1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të rregullojë organizimin dhe funksionimin e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në "Shkencat Mjekësore Teknike", në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.**
- 1.2. Rregullorja përcakton gjithashtu strukturat përgjegjëse për zbatimin e programit, si dhe kompetencat e përgjegjësitë përkatëse të tyre.**

"Neni 2" rinumërohet "Neni 3" i cili pasqyron edhe një modifikim të pjesëshëm si në vijim:

Neni 2 (ishte)

Kjo rregullore është hartuar në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, "PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"; VENDIMIT të Këshillit të Ministrave NR. 41, DATË 24.01.2018, "PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", I NDRYSHUAR; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018, "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore përfitimin e titujve akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor", i ndryshuar; VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 777, DATË 26.12.2018, "PËR KONTROLLIN ANTIPLAGJIATURË TË DISERTACIONEVE PËR FITIMIN E GRADAVE SHKENCORE", i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 75, datë 12.2.2018, "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor"; Udhëzimit të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 52, datë 03.12.2015 "PËR PËRCAKTIMIN E NIVELEVE TË GJUHËVE TË HUAJA DHE TË TESTEVE NDËRKOMBËTARE, PËR PRANIMET NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË DHE TË TRETË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", i ndryshuar; UDHËZIMIT TË MINISTRIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË NR. 16, DATË 08.07.2019, "PËR PAJSJEN E INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË ME REGJISTRIN THEMELTAR TË STUDENTËVE, REGJISTRIN E ARRITJEVE AKADEMIKE DHE REGJISTRIN E LËSHIMIT TË DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE"; UDHËZIMIT TË PËRBASHKËT TË MINISTRIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË DHE ATIJ TË FINANCAVE DHE EKONOMISË NR. 20, DATË 20.9.2019, "PËR SKEMËN DHE ZBATIMIN E MODELIT TË FINANCIIMIT TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR"; UDHËZIMIT TË MINISTRIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË NR. 29, DATË 18.12.2019, "PËR KRËJIMIN DHE ADMINISTRIMIN E REGJISTRAVE SHTETËRORE TË GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE AKADEMIKË TË LËSHUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"; UDHËZIMIT TË MINISTRIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË NR. 1, DATË 14.1.2020, "PËR DOKUMENTACIONIN DHE



PROCEDURAT PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN DHE MBYLLJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, DEGËVE TË TYRE, NJËSIVE KRYESORE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT, SI DHE PËR NDARJEN OSE BASHKIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË", i ndryshuar; UDHËZIMIT TË MINISTRIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË NR. 10, DATË 30.3.2020, "PËR PËRCAKTIMIN E ELEMENTËVE PËRBËRËS, FORMËN E DIPLOMËS OSE CERTIFIKATËS TË LËSHUAR NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË DHE PROCEDURËS SË REGJISTRIMIT TË TYRE NË REGJISTRIN SHTETËROR TË DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR"; UDHËZIMIT TË MINISTRIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË NR. 29, DATË 10.09.2018, "PËR VEPRIMTARINË DHE NGARKESËN MËSIMORE TË PERSONELIT AKADEMIK NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË"; si edhe Statutit të Universitetit të Elbasanit.

Neni 2 bëhet Neni 3:

Kjo rregullore është hartuar në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, "PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"; VENDIMIT të Këshillit të Ministrave NR. 41, DATË 24.01.2018, "PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", I ndryshuar me VKM nr. 185, datë 25.03.2021; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018, "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor", i ndryshuar me VKM nr. 128 datë 6.03.2024 "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 112, DATË 23.2.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE 'DOKTOR' DHE TË STANDARDEVE SHTETËRORE PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË 'PROFESOR I ASOCIUAR' DHE 'PROFESOR', TË NDRYSHUAR"; VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 777, DATË 26.12.2018, "PËR KONTROLLIN ANTIPLAGJIATURË TË DISERTACIONEVE PËR FITIMIN E GRADAVE SHKENCORE", i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 75, datë 12.2.2018, "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor"; Udhëzimit të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 52, datë 03.12.2015 "PËR PËRCAKTIMIN E NIVELEVE TË GJUHËVE TË HUAJA DHE TË TESTEVE NDRËKOMBËTARE, PËR PRANIMET NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË DHE TË TRETË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", i ndryshuar; UDHËZIMIT TË MINISTRIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË NR. 16, DATË 08.07.2019, "PËR PAJISJEN E INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË ME REGJISTRIN THEMELTAR TË STUDENTËVE, REGJISTRIN E ARRITJEVE AKADEMIKE DHE REGJISTRIN E LËSHIMIT TË DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE"; UDHËZIMIT TË PËRBASHKËT TË MINISTRIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË DHE ATIJ TË FINANCAVE DHE EKONOMISË NR. 20, DATË 20.9.2019, "PËR SKEMËN DHE ZBATIMIN E MODELIT TË FINANÇIMIT TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR"; UDHËZIMIT TË MINISTRIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË NR. 29, DATË 18.12.2019, "PËR KRIJIMIN DHE ADMINISTRIMIN E REGJISTRAVE SHTETËRORE TË GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE AKADEMIKË TË LËSHUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"; UDHËZIMIT TË MINISTRIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË NR. 1, DATË 14.1.2020, "PËR DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURAT PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN DHE MBYLLJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, DEGËVE TË TYRE, NJËSIVE KRYESORE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT, SI DHE PËR NDARJEN OSE BASHKIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË", i ndryshuar; UDHËZIMIT TË MINISTRIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË NR. 10, DATË 30.3.2020, "PËR PËRCAKTIMIN E ELEMENTËVE PËRBËRËS, FORMËN E DIPLOMËS OSE CERTIFIKATËS TË LËSHUAR NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË DHE PROCEDURËS SË REGJISTRIMIT TË TYRE NË REGJISTRIN SHTETËROR TË DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR"; UDHËZIMIT TË MINISTRIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË NR. 29, DATË 10.09.2018, "PËR VEPRIMTARINË DHE NGARKESËN MËSIMORE TË PERSONELIT AKADEMIK NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË"; si edhe Statutit të Universitetit të Elbasanit.

Shtohet një nen i ri i cili numërohet Neni 2 dhe përmbajtja e tij është si vijon:

2.1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kuadrit rregullues për organizimin dhe zhvillimin e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në "Shkencat Mjekësore Teknike", i bazuar në projektin e miratuar të kërkimit shkencor "Rritja e kapaciteteve kërkimore shkencore të profesioneve mjekësore teknike



në Qarkun e Elbasanit” të zhvilluar nga njësia kryesore “Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike”.

2.2. Kjo rregullore ka për objekt gjithashtu të nxisë zhvillimin e inovacionit në mendimin shkencor dhe formimin e studiuesve të rinj, me qëllim që të kontribuojnë në zhvillim kulturor dhe arsimor, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Në përputhje me prioritetet e politikave kombëtare për kërkimin shkencor dhe me objektivat e Zonës Evropiane të Kërkimit Shkencor (ERA), rregullorja synon të mbështesë rritjen e kapaciteteve kërkimore dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë, përmes zhvillimit të projekteve kombëtare e ndërkombëtare, dhe përmes integrimit në rrjete doktorale të nivelit kombëtar, evropian dhe ndërkombëtar, si shprehje e bashkëpunimit institucional dhe ndërkombëtarizimit të kërkimit shkencor.

“Neni 3” rinumërohet “Neni 4”

Neni 3 (ishte):

3.1 Programet e studimit të doktoratës përfshihen në ciklin e tretë të studimeve universitare, në përfundim të të cilit lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor".

3.2 Programi i doktoratës synon të nxisë kërkimin shkencor, duke u orientuar drejt thellimit, rikonceptimit dhe riintegritimit të njohurive shkencore, për të sjellë risi në mendimin shkencor.

3.3 Studimet e doktoratës kanë në themel të tyre kërkimin shkencor dhe veprimtarinë krijuese të pavarur, si bazë për përgatitjen e tezës së doktoratës, të nevojshme për marrjen e gradës shkencore "Doktor" dhe lidhen me projekte kërkimore të njëjësive bazë apo të njëjësive kryesore.

3.4 Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor, në fushat e përcaktuara nga njësitë bazë ose njësia kryesore. Njësitë bazë shpallin fushat kryesore sipas objektivave të tyre, ose fusha të përbashkëta ndërmjet tyre me prioritet për thellimin e kërkimit shkencor.

Neni 3 behet Neni 4

4.1. Programet e studimit të doktoratës përfshihen në ciklin e tretë të studimeve universitare, në përfundim të të cilit lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor”.

4.2. Studimet e doktoratës ndërtohen mbi bazën e programeve individuale të kërkimit, që synojnë aftësimin e pavarur të kandidatëve, dhe kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtarinë krijuese, përmes thellimit të njohurive, rikonceptimit kritik dhe integritimit të tyre, si bazë për përgatitjen e tezës së disertacionit të nevojshme për fitimin e gradës shkencore “Doktor”, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Neni 4 behet Neni 5

5.1. Njësitë bazë të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike janë përgjegjëse për organizimin dhe drejtimin e programit të studimit të doktoratës. Kriteret e pranimit të studentëve për në programin e studimit të doktoratës, përcaktohen nga njësitë bazë, i përcillen Dekanatit. Njëra prej



njësive bazë caktohet si përgjegjëse për ofrimin e programit të kërkimit të kandidatit, në dakordësi midis tyre.

5.2. Kolegji Doktoral është struktura përgjegjëse për zhvillimin e punës për kërkimin shkencor, për hapjen dhe riorganizimin e programit të doktoratës dhe ndjekjen e të gjitha fazave të procesit të doktoratës.

5.3. Programi i studimit të doktoratës drejtohet nga drejtuesi i njësisë kryesore (Dekani), në funksionin e Koordinatorit të Doktoratës.

5.4. Komisioni për dhënien e gradës shkencore “Doktor” është përgjegjës për të vlerësuar dosjen e disertantit, ngritjen e jurisë dhe për të marrë vendime për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.

5.5. Vlerësimi i disertacionit të kandidatit për gradën shkencore “Doktor” realizohet nga juria e posaçme, e ngritur për këtë qëllim.

“Neni 5” rinumërtohet “Neni 6”

Neni 5 (ishte)

5.1 Për të kryer regjistrimin në programet e studimit të doktoratës, aplikanti duhet të plotësojë këto kritere:

- të ketë përfunduar studimet e larta në Shkencat Mjekësore dhe të zotërojë një diplomë të ciklit të dytë "Master i shkencave"/"Master i arteve"; një diplomë të integruar të nivelit të dytë, ose një diplomë sipas sistemit të vjetër apo titull akademik të barasvlershëm, të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente";
- të ketë notë mesatare, mbi 8 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe të dytë. Përfshihen nga plotësimi i kriterit të notës mesatare, kandidatët e diplomuar jashtë vendit;
- të ketë mbrojtur një nga gjuhët e huaja: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht, në përputhje me nivelet e parashikuara në udhëzimin nr. 52, datë 03.12.2015, "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar;
- të ketë dy rekomandime nga persona, që kanë titullin "Profesor" ose "Profesor i asociuar", të cilët njohin aftësitë kërkimore shkencore dhe profesionale të kandidatit;
- të ketë paraqitur projektin kërkimor, në përputhje me projektin "Rritja e kapaciteteve kërkimore shkencore të profesioneve mjekësore", në momentin e aplikimit; të paraqesë një përmbledhje të temës së masterit (4 faqe), për studentët që zotërojnë një diplomë të ciklit të dytë "Master i shkencave"/"Master i arteve"; të ketë publikime të mëparshme kërkimore shkencore;
- të mos jenë marrë masa disiplinore ndaj tij apo të mos jenë gjetur shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës, si edhe të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike.

5.2 Aplikanti për të ndjekur programin e studimit të doktoratës bën një kërkesë, ku paraqet edhe propozimin për temën dhe objektivat e kërkimit shkencor. Kjo kërkesë përfshihet në dosjen personale, e cila përmban edhe dokumentet e mëposhtme:

- curriculum vitae;
- kopje të noterizuar të diplomave, të shoqëruara me suplementet e diplomës ose listën e notave me kreditet përkatëse. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes/ekuivalentimit nga ministria përgjegjëse për arsimin;



- *certifikatë lindjeje, si edhe fotokopje të kartës së identitetit/ pasaportës;*
- *dy rekomandime nga persona me titullin "Profesor" ose "Profesor i asociuar";*
- *dëshmi të gjuhës së huaj, përputhje me nivelet e parashikuara në udhëzimin nr. 52, datë 03.12.2015, "Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar;*
- *dëshmi dhe vërtetime në lidhje me kualifikime, trajnime, provime pasuniversitare ose artikuj shkencorë që mund të ketë kryer, pjesëmarrje në konferenca shkencore apo eksperiencë akademike;*
- *deklaratë vetjake e studentit për përballimin e shpenzimeve të programit të studimeve të doktoratës, nëse do të vetëfinancohet;*
- *projekt propozimin e kërkimit shkencor, ku të evidentohen qëllimi dhe objektivat, metodologjia që do të ndiqet, nevoja për studim të thelluar në fushën e propozuar dhe risitë që pritet të sjellë punimi;*
- *vërtetim nga qendra e punës, nëse kandidati është i punësuar;*
- *mandat pagese për tarifën e aplikimit;*
- *vetëdeklarim të aplikantit se do të zbatojë standardet shkencore dhe etike;*
- *vetëdeklarimi që nuk është subjekt i asnjë mase disiplinore të marrë ndaj tij.*

5.3. Udhëheqësi shkencor për studentin aplikant në programin e studimit të doktoratës duhet të ketë titullin "Profesor" ose "Profesor i Asociuar". Numri i doktorantëve që mund të udhëheqë personeli akademik në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, ku ai është angazhuar është:

- *jo më shumë se 3 (tre) në rastin e personelit akademik që mban titullin "Profesor";*
- *jo më shumë se 2 (dy), në rastin e personelit akademik që mban titullin "Profesor i asociuar".*

5.4 Dosja e kërkesës për regjistrim në programin e studimeve të doktoratës shqyrtohet nga Kolegji Doktoral, i cili përcakton metodologjinë dhe procedurat e vlerësimit të kandidatëve, të cilat bëhen transparente, shpallen dhe publikohen, së bashku me afatet e shqyrtimit të dosjeve.

5.5 Kolegji Doktoral bën përzgjedhjen dhe renditjen e kandidatëve, mbështetur në propozimin e aplikantit dhe në dokumentacionin në dosjen përkatëse, mbi pikëzimin e kritereve specifike të aplikantëve. Tabela e pikëzimit është bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

5.6 Kandidati ka të drejtë të ankimojë procedurën e vlerësimit të kandidatëve, brenda tri ditëve pune nga shpallja e listës paraprake të kandidatëve fitues. Ankimimi bëhet pranë dekanatit.

5.7 Midis kandidatit fitues dhe njësisë kryesore lidhet një kontratë, që rregullon aspektet akademike dhe financiare.

Neni 5 bëhet Neni 6

6.1. Në zbatim të nenit 78 të ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", për të kryer regjistrimin në programet e studimit të doktoratës, aplikanti duhet të plotësojë këto kritere:



- të ketë përfunduar studimet e larta në Shkencat Mjekësore dhe të zotërojë një diplomë të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve”; një diplomë të integruar të nivelit të dytë, ose një diplomë sipas sistemit të vjetër apo titull akademik të barasvlershëm, të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente”;
- **të ketë notë mesatare, mbi 8 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe të dytë. Përjashtohen nga plotësimi i kriterit të notës mesatare, kandidatët e diplomuar jashtë vendit. Në rastin kur rezultojnë se kandidatët vijnë me profile kërkimore dhe/ose profesionale të spikatur, pavarësisht mesatares, si dhe konsideruar rëndësinë e vijueshmërisë së projektit “Rritja e kapaciteteve kërkimore shkencore të profesioneve mjekësore teknike në Qarkun e Elbasanit” në zbatim dhe domosdoshmërisë për të patur kandidatë me profilin përkatës, strukturat kompetente vendimmarrëse përsa përcaktuar në këtë rregullore mund të marrin vendim për të vijuar procedurat e konkurimit.**
- të ketë mbrojtur një nga gjuhët e huaja: *anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht*, në përputhje me nivelet e parashikuara në udhëzimin nr. 52, datë 03.12.2015, “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar. **Nëse aplikanti ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.**
- të ketë dy rekomandime nga persona, që kanë titullin “Profesor” ose “Profesor i asociuar”, të cilët njohin aftësitë kërkimore shkencore dhe profesionale të kandidatit;
- të ketë paraqitur projektin kërkimor, në përputhje me projektin “Rritja e kapaciteteve kërkimore shkencore të profesioneve mjekësore”, në momentin e aplikimit;
- të paraqesë një përmbledhje të temës së masterit (4 faqe), për studentët që zotërojnë një diplomë të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve”;
- të ketë publikime të mëparshme kërkimore shkencore;
- të mos jenë marrë masa disiplinore ndaj tij apo të mos jenë gjetur shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës, si edhe të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike.

6.2. Aplikanti për të ndjekur programin e studimit të doktoratës bën një kërkesë, ku paraqet edhe propozimin për temën dhe objektivat e kërkimit shkencor. Kjo kërkesë përfshihet në dosjen personale, e cila përmban edhe dokumentet e mëposhtme:

- curriculum vitae;
- kopje të noterizuar të diplomave, të shoqëruara me suplementet e diplomës ose listën e notave me kreditet përkatëse. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes/ekuivalentimit nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- certifikatë lindjeje, si edhe fotokopje të kartës së identitetit/ pasaportës;
- dy rekomandime nga persona me titullin “Profesor” ose “Profesor i asociuar”;



- dëshmi të gjuhës së huaj, përputhje me nivelet e parashikuara në udhëzimin nr. 52, datë 03.12.2015, “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar;
- dëshmi dhe vërtetime në lidhje me kualifikime, trajnime, provime pasuniversitare ose artikuj shkencorë që mund të ketë kryer, pjesëmarrje në konferenca shkencore apo eksperiencat akademike;
- deklaratë vetjake e studentit për përballimin e shpenzimeve të programit të studimeve të doktoratës, nëse do të vetëfinancohet;
- projekt propozimin e kërkimit shkencor, ku të evidentohen qëllimi dhe objektivat, metodologjia që do të ndiqet, nevoja për studim të thelluar në fushën e propozuar dhe risitë që pritet të sjellë punimi;
- vërtetim nga qendra e punës, nëse kandidati është i punësuar;
- mandat pagese për tarifën e aplikimit;
- vetëdeklarim të aplikantit se do të zbatojë standardet shkencore dhe etike;
- vetëdeklarimi që nuk është subjekt i asnjë mase disiplinore të marrë ndaj tij.

6.3. Studentët aplikantë në programin e studimit të doktoratës udhëhiqen nga drejtuesit shkencorë që janë udhëheqësit shkencorë/bashkëudhëheqësit shkencorë, në zbatim të VKM nr. 128 datë 6.03.2024. Në rastin e bashkëudhëheqjes, bashkëdhëheqësi duhet të jetë personel akademik i kategorisë "Profesor", i cili duhet të jetë pjesë e personelit akademik të njësisë kryesore, ku zbatohet programi i doktoratës, sikurse mund të jetë pjesë e personelit akademik në një nga IAL brenda ose jashtë vendit, në bazë të një marrëveshjeje dypalëshe.

6.4. Udhëheqësi shkencor/bashkëudhëheqësi shkencor për studentin aplikant në programin e studimit të doktoratës duhet të ketë titullin “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”. Numri i doktorantëve që mund të udhëheqë personeli akademik në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, ku ai është angazhuar është:

- jo më shumë se 3 (tre) në rastin e personelit akademik që mban titullin “Profesor”;
- jo më shumë se 2 (dy), në rastin e personelit akademik që mban titullin “Profesor i asociuar”.

6.5. Në rastin kur udhëheqësi/bashkëudhëheqësi shkencor humbet statutin e personelit akademik me kohë të plotë/me kohë të pjesshme si dhe kur heq dorë për arsye objektive që e bëjnë të pamundur përmbushjen e kësaj detyre, Kolegji Doktoral cakton një udhëheqës/bashkëudhëheqës shkencor për të garantuar të drejtën e doktorantit për udhëheqje/bashkëudhëheqje.

6.6. Dosja e kërkesës për regjistrim në programin e studimeve të doktoratës shqyrtohet nga Kolegji Doktoral, i cili përcakton metodologjinë dhe procedurat e vlerësimit të kandidatëve, të cilat bëhen transparente, shpallen dhe publikohen, së bashku me afatet e shqyrtimit të dosjeve.

6.7. Kolegji Doktoral bën përzgjedhjen dhe renditjen e kandidatëve, mbështetur në propozimin e aplikantit dhe në dokumentacionin në dosjen përkatëse, mbi pikëzimin e kriterëve specifike të aplikantëve. Tabela e pikëzimit është bashkëlidhur kësaj rregulloreje emërtuar shtojca nr.1.



6.8. Kandidati ka të drejtë të ankimojë procedurën e vlerësimit të kandidatëve, brenda tri ditëve pune nga shpallja e listës paraprake të kandidatëve fitues. Ankimimi bëhet pranë Dekanatit.

6.9. Midis kandidatit fitues dhe njësisë kryesore lidhet një kontratë, që rregullon aspektet akademike dhe financiare.

“Neni 6” rinumërohet “Neni 7”

Neni 6 (ishte)

Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësia bazë ose njësia kryesore. Ato kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese. Viti doctoral do të realizohet duke patur parasysh kohëzgjatjen 3 deri 5 vjet, si në vijim:

Viti	Elementët e planit vjetor (3 vite)					
I	Formimi teorik Kërkimor shkencor	Pjesëmarrje në konferencat/	Aktivitetet specifike mbi metodologjinë e kërkimit shkencor	Asistencë në mesimdhënie lidhur me fushën e kërkimit	Shqyrtimi i literaturës	Hartimi i planit të projektit të kërkimit ku të përfshihen të paktën qëllimi, metodat e kërkimit, burimet e nevojshme, dhe rezultate të pritshme
II	Përmirësim/ndryshim i planit të projektit shkencor ose fillimi i tij nëse është miratuar nga komisioni përkatës	Aktivitetet klinik në spital ose institucione të tjera shëndetësore sipas fokusit të kërkimit	Publikime shkencore mbi gjetjet nga literatura	Zbatimi i projektit	Shqyrtim i literatures dhe Analiza statistikore	
III	Shkrimi i disertacionit	Pjesëmarrje në aktivitetet shkencore (konferenca seminare) me interes në fushën kërkimore	Prezantimi i punimeve në departament.	Perfundimi i disertacionit dhe detyrimeve të tjera si doktorant	Dorëzimi i disertacionit te komisioni, mbrojtja e tezës	

Viti	Elementët e planit vjetor (5 vite)					
I	Formimi teorik Kërkimor shkencor	Pjesëmarrje në konferenca/	Aktivitetet specifike mbi metodologjinë e kërkimit shkencor	Asistencë në mesimdhënie lidhur me fushën e kërkimit		
II			Shqyrtimi i literaturës	Hartimi i planit të projektit të kërkimit ku të përfshihen të paktën qëllimi, metodat e kërkimit, burimet e nevojshme, dhe rezultate të pritshme		
III	Përmirësim/ndryshim i planit të projektit shkencor ose fillimi i tij nëse është miratuar nga komisioni përkatës	Aktivitetet klinik në spital ose institucione të tjera shëndetësore sipas fokusit të kërkimit	Shqyrtim i literatures	Publikime shkencore mbi gjetjet nga literatura	Analiza statistikore	
IV	Zbatimi i projektit	Aktivitetet klinik në spital ose institucione të tjera shëndetësore sipas fokusit të kërkimit	Shqyrtim i literatures	Shqyrtimi i literatures	Shkrimi i disertacionit	
V	Shkrimi i disertacionit	Pjesëmarrje në aktivitetet shkencore (konferenca seminare) me interes në fushën kërkimore	Prezantimi i punimeve në departament.	Perfundimi i disertacionit dhe detyrimeve të tjera si doktorant	Dorëzimi i disertacionit te komisioni, mbrojtja e tezës	



Neni 6 bëhet Neni 7

7.1. Studimet në programin e studimit të ciklit të tretë Doktoratë në “Shkencat Mjekësore Teknike” bazohen në programe individuale të kërkimit, që synojnë aftësimin e pavarur të kandidatëve, që kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtarinë krijuese në fushën “Shëndet dhe Mirëqenie”, në përputhje me VKM Nr. 310, datë 11.5.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

7.2. Studimet e doktoratës kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtarinë krijuese që shtrihen përgjatë vitit doktoral. Viti doktoral do të realizohet duke patur parasysh kohëzgjatjen 3 deri 5 vjet, si në vijim:

Tabela 1: Elementët e Planit Vjetor 3 vjeçar

Viti	Elementët e planit vjetor (3 vite)					
I	Formimi teorik Kërkimor shkencor	Pjesëmarrje në konferencat shkencore	Aktivitete specifike mbi metodologjinë e kërkimit shkencor	Asistencë në mësimdhënie lidhur me fushën e kërkimit	Shqyrtimi i literaturës	Hartimi i planit të projektit të kërkimit ku të përfshihen të paktën qëllimi, metodat e kërkimit, burimet e nevojshme, dhe rezultate të pritshme
II	Përmirësim/ndryshim i planit të projektit shkencor ose fillimi i tij nëse është miratuar nga komisioni përkatës	Aktivitetet klinik në spital ose institucione të tjera shëndetësore sipas fokusit të kërkimit	Publikime shkencore mbi gjetjet nga literatura	Zbatimi i projektit	Shqyrtim i literatures dhe Analiza statistikore	
III	Shkrimi i disertacionit	Pjesëmarrje në aktivitete shkencore (konferenca/seminare) me interes në fushën kërkimore	Prezantimi i punimeve në departament.	Përfundimi i disertacionit dhe detyrimeve të tjera si doktorant	Dorëzimi i disertacionit të komisioni, mbrojtja e tezës	

Tabela 2: Elementët e Planit Vjetor 5 vjeçar



Viti	Elementët e planit vjetor (5 vite)				
I	Formimi teorik Kërkimor shkencor	Pjesëmarrje në konferenca/	Aktivitetet specifike mbi metodologjinë e kërkimit shkencor	Asistencë në mësimdhënie lidhur me fushën e kërkimit	
II			Shqyrtimi i literatures	Hartimi i planit të projektit të kërkimit ku të përfshihen të paktën qëllimi, metodat e kërkimit, burimet e nevojshme dhe rezultate të pritshme	
III	Përmirësim/ndryshim i planit të projektit shkencor ose fillimi i tij nëse është miratuar nga komisioni përkatës		Aktivitetet klinik në spital ose institucione të tjera shëndetësore sipas fokusit të kërkimit Shqyrtim i literatures	Publikime shkencore mbi gjetjet nga literatura	Analiza statistikore
IV	Zbatimi i projektit		Aktivitetet klinik në spital ose institucione të tjera shëndetësore sipas fokusit të kërkimit Shqyrtim i literatures	Shqyrtimi i literatures	Shkrimi i disertacionit
V	Shkrimi i disertacionit	Pjesëmarrje në aktivitete shkencore (konferenca/seminare) me interes në fushën kërkimore	Prezantimi i punimeve në departament	Përfundimi i disertacionit dhe detyrimeve të tjera si doktorant	Dorëzimi i disertacionit të komisioni, mbrojtja e tezës

7.3. Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” mund të bëhet pjesë e rrjeteve doktorale ndërkombëtare të mbështetura nga programe bashkëpunimi evropiane dhe ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor dhe formimit të studiuesve të rinj. Për doktorantët e përzgjedhur përmes këtyre rrjeteve, struktura dhe kalendari i vitit doktoral përcaktohen në përputhje me kërkesat e projektit përkatës dhe me marrëveshjet ndërinstitucionale të nënshkruara nga Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” me institucionet partnere. Në këtë rast, viti doktoral për doktorantët ndërkombëtarë fillon dhe përfundon në të njëjtat periudha si për doktorantët kombëtarë dhe atyre nga trojet.

7.4. Integrimi i doktorantëve ndërkombëtarë në programin e studimeve të ciklit të tretë Doktoratë në “Shkencat Mjekësore Teknike” bëhet në përputhje me standartet akademike dhe kërkimore të përcaktuara në këtë rregullore dhe në përputhje me dispozitat e marrëveshjeve ndërinstitucionale, duke respektuar njëkohësisht kërkesat specifike të programeve ndërkombëtare për mobilitet dhe bashkëpunim të ndërsjellë.

7.5. Doktorantët kombëtarë dhe nga trojet që zhvillojnë pjesë të programit të tyre të kërkimit në institucionet partnere ndërkombëtare, si pjesë e rrjeteve doktorale të njohura nga Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, kanë të drejtën e njohjes dhe përfshirjes të kësaj përvoje në kornizën e vitit doktoral dhe planin individual të kërkimit shkencor. Mobiliteti ndërkombëtar duhet të jetë i miratuar paraprakisht nga Kolegji Doktoral, në përputhje me marrëveshjet ndërinstitucionale. Një raport i detajuar mbi aktivitetet shkencore dhe akademike të kryera gjatë periudhës së mobilitetit duhet të dorëzohet pranë Kolegjit Doktoral, të cilët vlerësojnë përmbushjen e objektivave dhe integrimin e rezultateve në programin e doktoratës.

“Neni 7” rinumërohet “Neni 8”

Neni 7 (ishte)

7.1 *Gjatë periudhës së studimeve të doktoratës, para paraqitjes për mbrojtje, studenti duhet të ketë plotësuar kushtet e mëposhtme:*

- a)** *të ketë realizuar së paku, 3 (tri) referime ose paraqitje shkencore, si autor i parë ose i dytë, kur autori i parë është udhëheqësi shkencor, nga të cilët dy referime ose paraqitje të jetë*



mbajtur në një veprimtari shkencore/profesionale ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD, ose të G- 20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “proceedings”, të indeksuar me kod ISBN-je ose ISSN;

- b) të ketë botuar së paku 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore, nga të cilët 1 (një) të jetë botuar ose pranuar për botim në revista shkencore të rankuara në Journal Citation Reports ose Scopus, ku është së paku autor i dytë;
- c) të ketë përfunduar disertacionin, sipas formatit të përcaktuar në këtë rregullore dhe në rregulloret e lidhura me programin e tij të studimit. Disertacioni duhet të jetë në respektim të kuadrit ligjor dhe nënligjor, si edhe të akteve të miratuara nga UE, në lidhje me integritetin në kërkimin shkencor.

7.2 Të paktën një herë në vit, në fund të çdo viti akademik, Kolegji Doktorat duhet të shqyrtojë ecurinë e punës së studentit në programin e studimeve të doktoratës, bazuar në prezantimet vjetore të punës, që bën doktoranti dhe vlerësimet me shkrim që bën udhëheqësi, sipas një formati të paracaktuar (shtojca nr. 2). Doktoranti merr vlerësim pozitiv për të kaluar në vitin pasardhës, pasi ka plotësuar më shumë se 50%, sipas vlerësimit të aktiviteteve të planit vjetor të veprimtarive.

7.3 Disertacioni së bashku me dosjen, që përmban dokumentacionin që tregon plotësimin e kritereve si më sipër, i dorëzohet Kolegjit Doktorat, i cili vlerëson për të vijuar më tej me procedurat për mbrojtje, sipas përcaktimeve në vijim në këtë rregullore.

Neni 7 bëhet Neni 8

8.1. Gjatë periudhës së studimeve të doktoratës, para paraqitjes për mbrojtje, studenti duhet të ketë plotësuar kushtet e mëposhtme:

- a. të ketë realizuar së paku, 3 (tri) referime ose paraqitje shkencore, si autor i parë ose i dytë, kur autori i parë është udhëheqësi shkencor, nga të cilët dy referime ose paraqitje të jetë mbajtur në një veprimtari shkencore/profesionale ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD, ose të G- 20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “proceedings”, të indeksuar me kod ISBN-je ose ISSN;
- b. të ketë botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 1 (një) prej artikujve të jetë botuar në revista ndërkombëtare të indeksuara në Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimi të Journal Citation Report JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI), ku është së paku, autor i dytë.
- c. të ketë përfunduar disertacionin, sipas formatit të përcaktuar në këtë rregullore dhe në rregulloret e lidhura me programin e tij të studimit. Disertacioni duhet të jetë në respektim të kuadrit ligjor dhe nënligjor, si edhe të akteve të miratuara nga UE, në lidhje me integritetin në kërkimin shkencor. Disertacioni së bashku me dosjen që përmban dokumentacionin që



tregon plotësimin e kritereve sa më sipër i dorëzohet Kolegjit Doktoral i cili vlerëson për të vijuar më tej me procedurat për mbrojtje, sipas përcaktimeve në vijim në këtë rregullore.

8.2. Të paktën një herë në vit, në fund të çdo viti akademik, Kolegji Doktoral duhet të shqyrtojë ecurinë e punës së studentit në programin e studimeve të doktoratës, bazuar në prezantimet vjetore të punës, që bën doktoranti dhe vlerësimeve me shkrim që bën udhëheqësi, sipas një formati të paracaktuar (shtojca nr. 2). Doktoranti merr vlerësim pozitiv për të kaluar në vitin pasardhës, pasi ka plotësuar më shumë se 50%, sipas vlerësimit të aktiviteteve të planit vjetor të veprimtarive.

“Neni 8” rinumërohet “Neni 9”

“Neni 9” rinumërohet “Neni 10”

Neni 9 (ishte)

9.1. Udhëheqësi/ udhëheqësit shkencorë kanë përgjegjësitë si në vijim:

- të garantojë zbatimin e të gjitha rregullave shkencore dhe etike të kërkimit shkencor, gjatë periudhës së udhëheqjes së doktoratës;*
- të udhëheqë studentin për realizimin e kërkimit shkencor dhe përfundimin e disertacionit brenda kohës së parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore;*
- të japë mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t'i mundësojë kandidatit arritjen e standardeve të larta të kërkimit shkencor. Kjo përfshin, ndër të tjera, edhe orientim në lidhje me strukturën e punimit, metodologjinë, rekomandime mbi literaturën dhe burime të tjera të informacionit, si edhe konsulencë të vazhdueshme për përmbajtjen e punimit;*
- të mbajë komunikime të rregullta me studentin për ecurinë e punimit shkencor;*
- të vlerësojë progresin e studentit rregullisht dhe të monitorojë punën e tij në përputhje me standardin e kërkuar. Të ndërgjegjësojë studentin, në rastet kur puna e tij është nën standardin e kërkuar dhe të ndërmarrë veprimet e duhura mbështetëse;*
- të mbështesë studentin për përgatitjen e materialeve kërkimore, përfshirë artikuj dhe prezantime për konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në botime të tjera shkencore, kur tematika e tyre është në funksion të kërkimit shkencor dhe punimit të doktoratës dhe në përmbushje të kritereve të përcaktuara;*
- të kontrollojë se kandidati i ka plotësuar të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet, në rastet kur njësisia bazë e ka kthyer punimin për riparimit dhe/ose plotësimin e dosjes;*

Neni 9 bëhet Neni 10



Drejtuesit shkencorë “Udhëheqësi shkencor/ bashkëudhëheqësi shkencor” kanë përgjegjësitë si në vijim:

- të garantojë zbatimin e të gjitha rregullave shkencore dhe etike të kërkimit shkencor, gjatë periudhës së udhëheqjes së doktoratës;
- të udhëheqë studentin për realizimin e kërkimit shkencor dhe përfundimin e disertacionit brenda kohës së parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore;
- të japë mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t'i mundësojë kandidatin arritjen e standardeve të larta të kërkimit shkencor. Kjo përfshin, ndër të tjera, edhe orientim në lidhje me strukturën e punimit, metodologjinë, rekomandime mbi literaturën dhe burime të tjera të informacionit, si edhe konsulencë të vazhdueshme për përmbajtjen e punimit;
- të mbajë komunikime të rregullta me studentin për ecurinë e punimit shkencor;
- të vlerësojë progresin e studentit rregullisht dhe të monitorojë punën e tij në përputhje me standardin e kërkuar. Të ndërjegjësojë studentin, në rastet kur puna e tij është nën standardin e kërkuar dhe të ndërmarrë veprimet e duhura mbështetëse;
- të mbështesë studentin për përgatitjen e materialeve kërkimore, përfshirë artikuj dhe prezantime për konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në botime të tjera shkencore, kur tematika e tyre është në funksion të kërkimit shkencor dhe punimit të doktoratës dhe në përmbushje të kriterëve të përcaktuara;
- të kontrollojë se kandidati i ka plotësuar të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet, në rastet kur njësi bazë e ka kthyer punimin për riparaqitje dhe/ose plotësimin e dosjes;
- në rastet e bashkëudhëheqjes, udhëheqësit duhet të përcaktojnë qartë përgjegjësitë e tyre dhe duhet të mbajnë kontakte të rregullta.

“Neni 10” rinumërohet “Neni 11”

“Neni 10” ishte:

10.1. Kolegji Doktorat është struktura përgjegjëse për zhvillimin e punës për kërkimin shkencor, për hapjen dhe riorganizimin e programit të doktoratës dhe ndjekjen e të gjitha fazave të procesit të doktoratës.

10.2. përbëhet nga personeli akademik i cili është ngarkuar me udhëheqjen e studimeve doktorale si dhe koordinatori i doktoratës. Kryetar i kolegjit zgjidhet Profesori më i moshuar.

10.3 Kolegji Doktorat përcakton dhe miraton projektet kërkimore të secilit doktorant.



10.4 Kolegji Doktoral miraton udhëheqësit e punimeve të doktoratës.

10.5 Kolegji Doktoral ka përgjegjësi të garantojë përmbushjen e kritereve formale nga kandidatët, përpara shqyrtimit të dosjes së tyre nga Komisioni për dhënien e gradave.

10.6 Kolegji Doktoral ka përgjegjësi të shqyrtojë raportet e ecurisë së kërkimit shkencor, të paraqitura nga studentët dhe udhëheqësit dhe të garantojë se udhëheqësit kanë kontakt të rregullt me studentët. Në rastet kur konstaton probleme, propozon ndryshimet e nevojshme.

10.7 Kolegji Doktoral ka përgjegjësi të informojë studentët e pranuar në programin e saj të doktoratës për aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, përfshirë edhe këtë rregullore, që lidhen me procesin e fitimit të gradës shkencore.

10.8 Në kushtet e kërkesës për ndryshimin e temës së disertacionit, doktoranti paraqet një raport drejtuar Kolegjit Doktoral, të nënshkruar prej tij dhe udhëheqësit, ku të argumentohet ndryshimi i temës. Kolegji Doktoral, vendos për miratimin ose jo të ndryshimit të temës së disertacionit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga dorëzimi i kërkesës.

Neni 10 bëhet Neni 11

11.1. Kolegji Doktoral është struktura përgjegjëse për zhvillimin e punës për kërkimin shkencor, për hapjen dhe riorganizimin e programit të doktoratës dhe ndjekjen e të gjitha fazave të procesit të doktoratës.

11.2. Kolegji përbëhet nga jo më pak se 5 (pesë) anëtarë dhe jo më shumë se 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë. Anëtarët e Kolegjit Doktoral i përkasin kategorisë “Profesor” dhe janë personel akademik i cili është ngarkuar me udhëheqjen/bashkëudhëheqjen e studimeve doktrale, si në IAL brenda ose jashtë vendit dhe në institucione kërkimore brenda vendit dhe jashtë vendit në zbatim të marreveshjeve dypalëshe. Njëri nga anëtarët e Kolegjit Doktoral mban statutin e koordinatorit të doktoratës. Kolegji doktoral asistohet nga sekretari i tij. Kryetar i kolegjit zgjidhet Profeshori më i moshuar. Në rast mospranimi ose heqje dorë nga funksioni i kryetarit, kryetar i Kolegjit Doktoral zgjidhet anëtari më i moshuar në raport me anëtarët e tjerë.

11.3. Kolegji Doktoral përcakton dhe miraton projektet kërkimore të secilit doktorant.

11.4. Kolegji Doktoral miraton udhëheqësit e punimeve të doktoratës.

11.5. Kolegji Doktoral ka përgjegjësi të garantojë përmbushjen e kritereve formale nga kandidatët, përpara shqyrtimit të dosjes së tyre nga Komisioni për dhënien e gradave.

11.6. Kolegji Doktoral ka përgjegjësi të shqyrtojë raportet e ecurisë së kërkimit shkencor, të paraqitura nga studentët dhe udhëheqësit dhe të garantojë se udhëheqësit kanë kontakt të rregullt me studentët. Në rastet kur konstaton probleme, propozon ndryshimet e nevojshme.



11.7. Kolegji Doktoral ka përgjegjësi të informojë studentët e pranuar në programin e saj të doktoratës për aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, përfshirë edhe këtë rregullore, që lidhen me procesin e fitimit të gradës shkencore.

11.8. Në kushtet e kërkesës për ndryshimin e temës së disertacionit, doktoranti paraqet një raport drejtuar Kolegjit Doktoral, të nënshkruar prej tij dhe udhëheqësit, ku të argumentohet ndryshimi i temës, Kolegji Doktoral, vendos për miratimin ose jo të ndryshimit të temës së disertacionit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga dorëzimi i kërkesës.

11.9. Kolegji Doktoral ka kompetencë të përditësojë shtojcën që përshkruan elementët formalë që duhet të përmbushë punimi/disertacioni i kandidatit doktorant, përditësime që diktohen nga linjat guidë specifike në kërkimin shkencor, edhe në nivel ndërkombëtar, edhe në eventualitetin e rrjetëzimit ndërkombëtar.

“Neni 11” rinumërohet “Neni 12”

“Neni 12” rinumërohet “Neni 13”

Neni 12 (ishte)

- 12.1. *Komisioni për dhënien e gradës shkencore “Doktor” është Komision i përhershëm (KP) që ngrihet në nivel njësie kryesore. Ai është përgjegjës për monitorimin e procesit të dhënies së gradës shkencore “Doktor”.*
- 12.2. *Komisioni përbëhet nga jo më pak se 5 (pesë) anëtarë dhe jo më shumë se 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë, të cilët zgjidhen me vetëkandidim nga radhët e Asamblesë së personelit akademik. Anëtarët duhet të kenë titullin akademik “Profesor” ose “Profesor i Asociuar” dhe të kenë jo më pak se 10 (dhjetë) vite përvojë pune me kohë të plotë, si personel akademik.*
- 12.3. *Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin e dosjes së kandidatit dhe nëse vlerëson që dosja përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe përmbush kriteret e përcaktuara në këtë rregullore, ngre jurinë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja në shqyrtim e dosjes.*
- 12.4. *Komisioni është organi kompetent për vendimmarrjen në lidhje me dhënien e gradës Shkencore “Doktor”, pas shqyrtimit të raportit të vlerësimit të jurisë.*

Neni 12 bëhet Neni 13

13.1. Komisioni për dhënien e gradës shkencore “Doktor” është Komision i përhershëm (KP) që ngrihet në nivel njësie kryesore. Ai është përgjegjës për monitorimin e procesit të dhënies së gradës shkencore “Doktor”.

13.2. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 5 (pesë) anëtarë dhe jo më shumë se 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë, të cilët duhet ti përkasin kategorisë “Profesor” dhe zgjidhen me vetëkandidim.



Kandidatët për anëtarë duhet të jenë pjesë e personelit akademik të FSHMT-së/IAL brenda vendit ose jashtë vendit, si dhe të kenë përvojë pune si personel akademik. I njihet e drejta e kandidimit edhe personelit akademik i kategorisë “Profesor” që janë udhëheqës/bashkëudhëheqës dhe që janë pjesë e IAL-ve brenda ose jashtë vendit, në bazë të një marrëveshjeje dypalëshe.

13.3. Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin e dosjes së kandidatit dhe nëse vlerëson që dosja përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe përmbush kriteret e përcaktura në këtë rregullore, përfshirë edhe kontrollin antiplagjiaturë në zbatim të normativës ligjore në fuqi, ngre jurinë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja në shqyrtim e dosjes.

13.4. Komisioni është organi kompetent për vendimmarrjen në lidhje me dhënien e gradës Shkencore “Doktor”, pas shqyrtimit të raportit të vlerësimit të jurisë.

“Neni 13” rinumërohet “Neni 14”

“Neni 14” rinumërohet “Neni 15”

Neni 14 (ishte)

14.1 Mbrojtja e doktoratës bëhet përpara një jurie të përbërë nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 2 (dy) anëtarë i përkasin stafit akademik të njësisë bazë nga institucionet homologe vendase ose të huaja.

14.2 Ngritja e jurisë bëhet pasi kandidati i ka plotësuar të gjitha kërkesat e parashikuara në këtë rregullore dhe ka përfunduar disertacionin e tij. Ai e dorëzon disertacionin e përfunduar, së bashku me dosjen, pranë drejtuesit të njësisë kryesore, i cili ia përcjell për vlerësim njësisë bazë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e dorëzimit. Pas vlerësimit nga njësia bazë disertacioni dhe dosja e kandidatit i përcillen Komisionit për dhënien e gradës shkencore “Doktor”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Komisioni, nëse e vlerëson pozitivisht dosjen, brenda 30 (tridhjetë) ditëve ngre jurinë për vlerësimin e disertacionit.

14.3 Komisioni për dhënien e gradave përzgjedh anëtarët e jurisë nga një listë me jo më pak se 8 (tetë) anëtarë, propozuar nga njësia bazë dhe e miratuar nga drejtuesi i njësisë kryesore. Anëtarët e jurisë duhet t'i përkasin kategorisë “Profesor” dhe/ose “Profesor i asociuar”. Dy anëtarë të jurisë caktohen oponentë për vlerësimin e disertacionit, ku njëri është anëtar i jashtëm. Njëri prej anëtarëve të jurisë caktohet kryetar i saj.

14.4 Juria cakton datën e mbrojtjes së disertacionit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga formimi i saj.

14.5 Kur për arsye të përlegjura, njëri nga anëtarët e jurisë nuk mund të jetë i pranishëm në datën e caktuar për mbrojtjen e doktoratës, përgjegjësi i njësisë bazë vë në dijeni drejtuesin e njësisë kryesore, duke i propozuar edhe një datë tjetër për mbrojtjen. Drejtuesi i njësisë kryesore vë në dijeni Komisionin për dhënien e gradës shkencore “Doktor”. Juria merr vendim për ndryshimin e datës së mbrojtjes së doktoratës pas njoftimit dhe miratimit paraprak nga Komisioni për dhënien e gradës shkencore “Doktor”. Kjo procedurë zbatohet edhe në rastin kur doktoranti,



për arsye të përligjura, nuk mund të jetë i pranishëm në datën e caktuar për mbrojtjen e doktoratës.

14.6 Pas prezantimit të disertacionit nga doktoranti, juria harton raportin e vlerësimit dhe ia dërgon atë Komisionit për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.

14.7 Komisioni për dhënien e gradave, pasi merr raportin e vlerësimit nga juria, brenda 10 (dhjetë) ditëve, merr vendimin mbi dhënien e gradës shkencore “Doktor” dhe ia përcjell atë për procedura të mëtejshme drejtuesit të njësisë kryesore.

Neni 14 bëhet Neni 15

15.1. Mbrojtja e doktoratës bëhet përpara një jurie të përbërë nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 2 (dy) anëtarë i përkasin stafit akademik të njësisë bazë nga institucionet homologe vendase ose të huaja.

15.2. Ngritja e jurisë bëhet pasi kandidati i ka plotësuar të gjitha kërkesat e parashikuara në këtë rregullore dhe ka përfunduar disertacionin e tij. Ai e dorëzon disertacionin e përfunduar, së bashku me dosjen, pranë drejtuesit të njësisë kryesore, i cili ia përcjell për vlerësim njësisë bazë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e dorëzimit. **Njësia bazë, pas vlerësimit të disertacionit dhe kryerjes së kontrollit antiplagjiaturë, ia përcjell disertacionin dhe dosjen e kandidatit e shoqëruar dhe me vetëdeklarimin e kandidatit mbi raportin e ngjashmërisë, komisionit për dhënien e gradës shkencore “Doktor”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve.**

15.3. Komisioni, nëse e vlerëson pozitivisht dosjen, brenda 30 (tridhjetë) ditëve ngre jurinë për vlerësimin e disertacionit.

15.4. Komisioni për dhënien e gradave përzgjedh anëtarët e jurisë nga një listë me jo më pak se 5 (**pesë**) anëtarë, propozuar nga njësia bazë dhe e miratuar nga drejtuesi i njësisë kryesore. Anëtarët e jurisë duhet t'i përkasin kategorisë “Profesor” dhe/ose “Profesor i asociuar”. Dy anëtarë të jurisë caktohen oponentë për vlerësimin e disertacionit, ku njëri është anëtar i jashtëm. Njëri prej anëtarëve të jurisë caktohet kryetar i saj.

15.5. Juria cakton datën e mbrojtjes së disertacionit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga formimi i saj.

15.6. Kur për arsye të përligjura, njëri nga anëtarët e jurisë nuk mund të jetë i pranishëm në datën e caktuar për mbrojtjen e doktoratës, përgjegjësi i njësisë bazë vë në dijeni drejtuesin e njësisë kryesore, duke i propozuar edhe një datë tjetër për mbrojtjen. Drejtuesi i njësisë kryesore vë në dijeni Komisionin për dhënien e gradës shkencore “Doktor”. Juria merr vendim për ndryshimin e datës së mbrojtjes së doktoratës pas njoftimit dhe miratimit paraprak nga Komisioni për dhënien e gradës shkencore “Doktor”. Kjo procedurë zbatohet edhe në rastin kur doktoranti, për arsye të përligjura, nuk mund të jetë i pranishëm në datën e caktuar për mbrojtjen e doktoratës.

15.7. Pas prezantimit të disertacionit nga doktoranti, juria harton raportin e vlerësimit dhe ia dërgon atë Komisionit për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.



15.8. Komisioni për dhënien e gradave, pasi merr raportin e vlerësimit nga juria, brenda 10 (dhjetë) ditëve, merr vendimin mbi dhënien e gradës shkencore “Doktor” dhe ia përcjell atë për procedura të mëtejshme drejtuesit të njësisë kryesore.

“Neni 15” rinumërtohet “Neni 16”

“Neni 16” rinumërtohet “Neni 17”

“Neni 17” rinumërtohet “Neni 18”

“Neni 18” rinumërtohet “Neni 19”

Neni 18 (ishte)


18.1 Punimi hartohet në gjuhën shqipe dhe një përmbledhje e tij (2000-4000 fjalë) hartohet në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht), në format të shtypur dhe elektronik. Përpara dorëzimit punimi miratohet nga udhëheqësi shkencor.

18.2 *Punimi lidhet në pesë kopje origjinale. Në kopertinë duhet të vendoset:*

- *emri i universitetit (në krye, në mes të kopertinës);*
- *emri i fakultetit (në krye, në mes të kopertinës);*
- *emri i departamentit, ku është zhvilluar programi i doktoratës (në krye, në mes të kopertinës);*
- *stema e universitetit (në krye, në anën e majtë të kopertinës);*
- *stema e fakultetit (në krye, në anën e djathtë të kopertinës);*
- *fjala DISERTACION (në mes të kopertinës);*
- *emri i programit të doktoratës (në mes të kopertinës);*
- *emri i kandidatit (në fund, në anën e majtë të kopertinës);*
- *emri dhe grada e udhëheqësit (në fund, në anën e djathtë të kopertinës);*
- *qyteti dhe viti i mbrojtjes (në fund, në mes të kopertinës).*

18.3 *Punimi shkencor ose disertacioni duhet të përbëhet nga këto pjesë kryesore:*

- *abstrakti;*
- *mirënjohja;*
- *tabela e përmbajtjes;*
- *studimi;*
 - *hyrja;*
 - *shqyrtimi i literaturës së fushës dhe të çështjes;*
 - *shqyrtimi i materialit të vjelë dhe qëndrimi vetjak;*
 - *përfundime;*
 - *bibliografia;*
 - *shtojca.*



18.4 Punimi duhet të respektojë kërkesat e formatit.

1. Nëse formati nuk prezantohet sipas formatit të kërkuar, ai nuk pranohet derisa të plotësohen të gjitha kërkesat e formatit.

2. Punimi shkencor ose disertacioni duhet të realizojë këto anë teknike:

2.1. *Abstrakti.* Çdo punim duhet të përmbajë një abstrakt. Abstrakti duhet të jetë një përmbledhje që paraqet pikat kryesore dhe përfundimet e punimit. Abstrakti duhet të vendoset para falënderimeve dhe tabelës së përmbajtjes.

2.2. *Mirënjohja.* Duhet paraqitur mirënjohja për të gjithë ata që kanë kontribuar në realizimin e punimit dhe financimin e tij.

2.3. *Tabela e përmbajtjes.* Në këtë seksion paraqitet tabela e përmbajtjes me elementet e strukturës së punimit, titujt përkatës dhe numrin e faqeve për secilin element.

3. Studimi. Studimi, përgjithësisht, duhet të ketë këtë format:

3.1. *Hyrja.* Seksioni i hyrjes duhet të prezantojë fushën e studimit, çështjen e marrë në studim, detyrën shkencore, të përmbledhë informacionin e rëndësishëm dhe strukturën e punimit.

3.2. *Lista e shtojcave.* Në këtë seksion paraqiten vetëm listat e tabelave, ilustrimeve, shtojcave të përdorura në punim. Ky seksion përfshihet nëse tema jep mundësi për përdorimin e tabelave, ilustrimeve, shtojcave.

3.3. *Shqyrtimi i literaturës së fushës dhe të çështjes.* Në këtë pjesë paraqiten kontributet e identifikuar nga autorët e mëparshëm.

3.4. *Shqyrtimi i materialit të mbledhur dhe qëndrimi vetjak i doktorantit.*

3.5. *Përfundime.* Ky seksion përmbledh gjetjet kryesore të studimit.

3.6. *Propozime të tjera.* Ky seksion nuk është i detyrueshëm dhe kërkohet vetëm nëse rezultatet justifikojnë kërkimin e mëtejshëm.

3.7. *Bibliografia.* Të gjitha punimet shkencore duhet të përdorin literaturën dhe për citatat të tregojnë burimin e tyre. Seksioni i bibliografisë duhet të vendoset në faqe më vete.

3.8. *Shtojcat.* Ky seksion përmban ilustrime shtesë, të dhëna e shifra origjinale që janë shumë të gjata për t'u përfshirë në tekst. Ato përfshihen në "Shtojca" në mënyrë që të mos e shkëpusin lexuesin nga diskutimet origjinale. Shtojcat mund të ndahen në seksione. Secila shtojcë ka titullin e vet dhe mund edhe të paraqitet veçmas në faqen e tabelës së përmbajtjes. Në këtë rubrikë përfshihen materiale të tilla plotësuese, si: instrumente të ndryshme të kërkimit të përdorura në studim, pyetësorë, intervista, harta, dokumente ligjore, historike, seri fotografish etj.

4. Të gjithë kapitujt, çështjet, rubrikat e studimit renditen me rend numerik.

18.5 Format i punimit shkencor ose disertacioni duhet të respektojë kërkesat në vijim. Nëse punimi nuk prezantohet sipas formatit të kërkuar, ai nuk pranohet derisa të plotësohen të gjitha kërkesat e formatit.

1. *Lidhja.* Tri kopje të punimit shkencor duhet të lidhen. Njëra prej kopjeve duhet të jetë origjinalja. Në kopertinë duhet të vendoset emri i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", i Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, i programit, titulli i plotë i temës, emri i



kandidatit, emrii udhëheqësit shkencor, viti i mbrojtjes.

2. Disertacioni shoqërohet me një përmbledhje rreth 10 faqe në gjuhën angleze. Përdoret madhësia 12-çe e shkronjave. Ky element duhet t'u mundësojë lexuesve të kuptojnë sesi është trajtuar çështja e marrë në studim.
1. Fushën dhe fjalët kyçe. Studenti në bashkëpunim me udhëheqësin shkencor përcakton fushën dhe zgjedh fjalët kyçe në funksion të përshtatshmërisë së tyre me terminologjinë epërdorur në disiplinën përkatëse. Ato ndihmojnë identifikimin e tezës midis katalogëve kolektive në biblioteka.
2. Gjatësia e punimit. Pjesa e studimit shkencor për diplomën e gradës shkencore "Doktor" përcaktohet nga Komisioni i përhershëm (KP). Si rregull duhet të ketë jo më pak se 120 dhe jo më shumë se 160 faqe kompjuterike. Referencat, shënimet në fund të faqes, shtojcat, tabelat, diagramet nuk përfshihen në këtë përllogaritje.
3. Vendi që zënë elementet e punimit:
 - hyrja: 10 %;
 - shqyrtimi i literaturës së fushës dhe të çështjes: 30%;
 - shqyrtimi i materialit të mbledhur dhe qëndrimi vetjak: 45%;
 - përfundime: 10%;
 - bibliografia: 5%.
4. Për të llogaritur kufirin e fjalëve dhe të faqeve rekomandohet metoda e mëposhtme e llogaritjes:
 - maksimumi 2310 karaktere për faqe për punimin e mikrotezës;
 - numri i karaktereve llogaritet duke përfshirë hapësirën, pikësimin në një radhë dhe shumëzohet me numrin e radhëve;
 - në një radhë do të ketë 70 karaktere me një maksimum prej 33 radhësh.
5. Duhet përdorur letër e cilësisë së lartë, e bardhë, format A4.
6. Materiali duhet të shtypet vetëm nga njëra anë e letrës. Të gjitha kopjet e studimit duhet të jenë të shtypura me kompjuter, të printuara qartë dhe të jenë të lexueshme lehtësisht. Dorëshkrimet nuk pranohen.
7. Teksti duhet të shtypet me hapësirë një e gjysmë ndërmjet radhëve. Hapësira njëshe do të përdoret për përgatitjen e tabelave të gjata, të ekstrakteve, të shënimeve, të shpjegimeve të gjata dhe të listës së bibliografisë. Vetëm një lloj shkrimi duhet përdorur. Lloji i shkrimit duhet të jetë Times New Roman. Masa e shkronjës duhet të jetë 12-she.
8. Margjinat për të gjithë tekstin do të jenë:
 - Margjina e sipërme: 1 "
 - Margjina e poshtme: 1 "
 - Margjina e majtë: 1.25 "
 - Margjina e djathtë: 1.25 "



9. Numrat e faqeve. Të gjitha numrat e faqeve duhet të vendosen poshtë, në mes të faqes.

- Hyrja duhet të ketë numra romakë.
- Pjesa e studimit duhet të ketë numra arabë.
- Faqet e bibliografisë, shtojcave duhet të numërohen me numra arabë në vijim të numrave të tekstit.

10. Studentët këshillohen të përdorin referenca të botimeve të ndryshme të fushës, të raporteve ose të disertacioneve të kandidatëve të suksesshëm të cilat mund të gjenden në biblioteka. Madhësia e shkronjave të shënimeve është më e vogël se ajo e tekstit. Shënimet në fund të faqes (footnote), si dhe të gjitha llojet e tjera të shënimeve duhet të shkruhen me shkronja me madhësi 10-she

Neni 18 bëhet Neni 19

NENI 19

19.1. Për sa i përket elementëve formalë që duhet të përmbushë punimi/disertacioni i kandidatit doktorant, ato përcaktohen në një format përshkruar i detajuar në shtojcën bashkëlidhur kësaj rregullore emërtuar shtojca 3.

19.2. Konsideruar përditësimet e nevojshme të formatit të përshkruar që diktohen nga linjat guidë specifike në kërkimin shkencor, edhe në nivel ndërkombëtar, si edhe në eventualitetin e rrjetëzimit ndërkombëtar, është kompetencë e Kolegjit Doktoral përta përcaktuar edhe në nenin 11 të kësaj rregulloreje.

“Neni 19” rinumërtohet “Neni 20”

“Neni 20” rinumërtohet “Neni 21”

“Neni 21” rinumërtohet “Neni 22”

“Neni 22” rinumërtohet “Neni 23”

“Neni 23” rinumërtohet “Neni 24”

“Neni 24” rinumërtohet “Neni 25”

Shtojca nr 1 (ishte)

Shtojca nr.1

Mbi pikëzimin në procesin e konkurrimit në programin e studimit Doktoratë në Shkencat Mjekësore Teknike



<i>Doktoratë në Shkencat Mjekësore Teknike Viti akademik 2021-2022</i>	
<i>Vende të disponueshme</i>	5
<i>Kohëzgjatja e programit</i>	<i>Studimi me kohë normale, shprehur në vite: 3</i> <i>Studimi kohë të zgjatur, shprehur në vite: 5</i>
<i>Kurrikula</i>	<i>Shkenca Mjekësore Teknike</i>
<i>Strukturat përgjegjëse</i>	<i>Departamenti i Infermieristikës Departamenti i Lëndëve Paraklinike</i> <i>Departamenti i Lëndëve Klinike</i> <i>Departamenti Specialiteteve Tekniko-Mjekësore</i>
<i>Faqja web</i>	https://uniel.edu.al/fakultetet/fakulteti-i-shkencave-mjekesore-teknike
<i>Koordinatori</i>	<i>Prof.as.dr. Shkëlqim Hidri</i> shkelqim.hidri@uniel.edu.al
<i>Kriteret e pranimit</i>	<p><i>Për të kryer regjistrimin në programet e studimit të doktoratës, aplikantiduhet të plotësojë këto kritere:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <i>• të ketë përfunduar studimet e larta në Shkencat Mjekësore Teknike dhe të zotërojë një diplomë të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve”; një diplomë të integruar të nivelit të dytë, ose një diplomë sipas sistemit të vjetër apo titull akademik të barasvlershëm, të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente”;</i> <i>• të ketë notë mesatare, mbi 8 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe të dytë. Përfshihen nga plotësimi i kriterit të notës mesatare, kandidatët e diplomuar jashtë vendit;</i> <i>• të ketë mbrojtur një nga gjuhët e huaja: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht, në përputhje me nivelet e parashikuara në udhëzimin nr. 52, datë 03.12.2015, “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimit në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar;</i>



	<p>të ketë dy rekomandime nga persona, që kanë titullin “Profesor ose “Profesor i asociuar”, të cilët njohin aftësitë kërkimore shkencore dhe profesionale të kandidatit;</p> <p>të ketë paraqitur projektin kërkimor, në përputhje me projektin “Rritja e kapaciteteve kërkimore shkencore të profesioneve mjekësore”, në momentin e aplikimit;</p> <p>të paraqesë një përmbledhje të temës së masterit (4 faqe), për studentët që zotërojnë një diplomë të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve”;</p> <p>të ketë publikime të mëparshme kërkimore shkencore;</p> <p>të mos jenë marrë masa disiplinore ndaj tij apo të mos jenë gjetur shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës, si edhe të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike.</p>
--	---



<p><i>Dokumentacioni për aplikim</i></p>	<p><i>Aplikanti për të ndjekur programin e studimit të doktoratës bën një kërkesë, ku paraqet edhe propozimin për temën dhe objektivat e kërkimit shkencor. Kjo kërkesë përfshihet në dosjen personale, e cila përmban edhe dokumentet e mëposhtme:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>curriculum vitae;</i> • <i>kopje të noterizuar të diplomave, të shoqëruara me suplementet e diplomës ose listën e notave me kreditet përkatëse. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes/ekuivalentimit nga ministria përgjegjëse për arsimin;</i> • <i>certifikatë lindjeje, si edhe fotokopje të kartës së identitetit/pasaportës;</i> • <i>dy rekomandime nga persona me titullin “Profesor” ose “Profesor i asociuar”;</i> • <i>dëshmi të gjuhës së huaj në përputhje me nivelet e parashikuara në udhëzimin nr. 52, datë 03.12.2015, “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar;</i> • <i>dëshmi dhe vërtetime në lidhje me kualifikime, trajnime, provime pasuniversitare ose artikuj shkencorë që mund të ketë kryer, apo pjesëmarrje në konferenca shkencore, eksperiencë akademike;</i> • <i>deklaratë vetjake e studentit për përballimin e shpenzimeve të programit të studimeve të doktoratës, nëse do të vetëfinancohet;</i> • <i>projekt propozimin e kërkimit shkencor, ku të evidentohen</i>
--	---



	<p>objektivat e kërkimit shkencor, metodologjia që do të ndiqet, nevoja për studim të thelluar në fushën e propozuar dhe risitë, që pritet të sjellë punimi;</p> <ul style="list-style-type: none"> • vërtetim nga qendra e punës, nëse kandidati është i punësuar; • mandat pagese për tarifën e aplikimit; • vetëdeklarim të aplikantit se do të zbatojë standardet shkencore dhe etike; • vetëdeklarimi që nuk është subjekt i asnjë mase disiplinore të marrë ndaj tij.
<i>Procedura e konkurrimit</i>	<i>Vlerësimi i dosjes, provim me shkrim, provim me gojë</i>
<i>vlerësimi i dokumentacionit për aplikim</i>	<p>vlerësimi i kualifikimeve të bashkangjitura në aplikim nga secili kandidat. Pikët maksimale janë 50 pikë, të ndara si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - nota mesatare mbi 8 (10 pikë); - projekti kërkimor i paraqitur (20 pikë); - publikime të mëparshme (10 pikë); - vlerësimi i përmbledhjes së temës së masterit (5 pikë); - eksperiencë në mësimdhënie (5 pikë).
<i>provimi meshkrim</i>	<p>Pikët maksimale janë 25.</p> <p>Testi kalohet me minimumi 10 pikë. Testi konsiston në zhvillimin me shkrim të një tematike të caktuar nga Kolegji Doktorat. Temat publikohen bashkë me shpalljen e konkurrimit.</p>
<i>provimi me gojë</i>	<p>Pikët maksimale janë 25.</p> <p>Provimi me gojë konsiston në një prezantim të detajuar të projektit të kërkimit, të prezantuar nga kandidati si edhe certifikimin e njohurive në gjuhë të huaj.</p>

Shtojca nr 1 (bëhet)

Shtojca nr.1

Mbi pikëzimin në procesin e konkurrimit në programin e studimit Doktoratë në Shkencat Mjekësore Teknike



Doktoratë në Shkencat Mjekësore Teknike Viti akademik	
Vende të disponueshme	<i>(përcaktohet me vendim të Kolegjit Doktoral që aprovohe nga Senati akademik)</i>
Kohëzgjatja e programit	Studimi me kohë normale, shprehur në vite: 3 Studimi kohë të zgjatur, shprehur në vite: 5
Kurrikula	Shkenca Mjekësore Teknike
Strukturat përgjegjëse	Departamenti i Infermieristikës Departamenti i Lëndëve Paraklinike Departamenti i Lëndëve Klinike Departamenti Specialiteteve Tekniko-Mjekësore
Faqja ëeb	https://uniel.edu.al/fakultetet/fakulteti-i-shkencave-mjekesore-teknike
Koordinatori	Prof.as.dr. Brunilda Elezi <u>brunilda.elezi@uniel.edu.al</u>
Kriteret e pranimit	<p>Për të kryer regjistrimin në programet e studimit të doktoratës, aplikantiduhet të plotësojë këto kritere:</p> <ul style="list-style-type: none"> të ketë përfunduar studimet e larta në Shkencat Mjekësore dhe të zotërojë një diplomë të ciklit të dytë “Master i shkencave”/”Master i arteve”; një diplomë të integruar të nivelit të dytë, ose një diplomë sipas sistemit të vjetër apo titull akademik të barasvlershëm, të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente”; të ketë notë mesatare, mbi 8 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe të dytë. Përfshihen nga plotësimi i kriterit të notës mesatare, kandidatët e diplomuar jashtë vendit. Në rastin kur rezulton se kandidatët vijnë me profile kërkimore dhe/ose profesionale të spikatur, pavarësisht mesatares, si dhe konsideruar rëndësinë e vijueshmërisë së projektit “Rritja e kapaciteteve kërkimore shkencore të profesioneve mjekësore teknike në Qarkun e Elbasanit” në zbatim nga njësitë bazë të FSHMT-së dhe domosdoshmërisë të këtyre të fundit për të patur kandidatë me profilin përkatës, njësitë bazë mund të marrin vendim për të vijuar procedurat e konkurimit. të ketë mbrojtur një nga gjuhët e huaja: <i>anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht</i>, në përputhje me nivelet e parashikuara në udhëzimin nr. 52, datë 03.12.2015, “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimit në



	<p>programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.</p> <ul style="list-style-type: none"> • të ketë dy rekomandime nga persona, që kanë titullin “Profesor” ose “Profesor i asociuar”, të cilët njohin aftësitë kërkimore shkencore dhe profesionale të kandidatit; • të ketë paraqitur projektin kërkimor, në përputhje me projektin “Rritja e kapaciteteve kërkimore shkencore të profesioneve mjekësore”, në momentin e aplikimit; • të paraqesë një përmbledhje të temës së masterit (4 faqe), për studentët që zotërojnë një diplomë të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve”; • të ketë publikime të mëparshme kërkimore shkencore; • të mos jenë marrë masa disiplinore ndaj tij apo të mos jenë gjetur shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës, si edhe të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike.
<p>Dokumentacioni për aplikim</p>	<ul style="list-style-type: none"> • curriculum vitae; • kopje të noterizuar të diplomave, të shoqëruara me suplementet e diplomës ose listën e notave me kreditet përkatëse. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes/ekuivalentimit nga ministria përgjegjëse për arsimin; • certifikatë lindjeje, si edhe fotokopje të kartës së identitetit/pasaportës; • dy rekomandime nga persona me titullin “Profesor” ose “Profesor i asociuar”; • dëshmi të gjuhës së huaj, përputhje me nivelet e parashikuara në udhëzimin nr. 52, datë 03.12.2015, “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar; • dëshmi dhe vërtetime në lidhje me kualifikime, trajnime, provime pasuniversitare ose artikuj shkencorë që mund të ketë kryer.



	<p>pjesëmarrje në konferenca shkencore apo eksperiencia akademike;</p> <ul style="list-style-type: none"> • deklaratë vetjake e studentit për përballimin e shpenzimeve të programit të studimeve të doktoratës, nëse do të vetëfinancohet; • projekt propozimin e kërkimit shkencor, ku të evidentohen qëllimi dhe objektivat, metodologjia që do të ndiqet, nevoja për studim të thelluar në fushën e propozuar dhe risitë që pritet të sjellë punimi; • vërtetim nga qendra e punës, nëse kandidati është i punësuar; • mandat pagese për tarifën e aplikimit; • vetëdeklarim të aplikantit se do të zbatojë standardet shkencore dhe etike; • vetëdeklarimi që nuk është subjekt i asnjë mase disiplinore të marrë ndaj tij.
Procedura e konkurrimit	Vlerësimi i dosjes, provim me shkrim, provim me gojë
vlerësimi i dokumentacionit për aplikim	<p>vlerësimi i kualifikimeve të bashkangjitura në aplikim nga secili kandidat. Pikët maksimale janë 50 pikë, të ndara si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - nota mesatare mbi 8 (10 pikë); - projekti kërkimor i paraqitur (20 pikë); - publikime të mëparshme (10 pikë); - vlerësimi i përmbledhjes së temës së masterit (5 pikë); - eksperiencë në mësimdhënie (5 pikë).
provimi me shkrim	<p>Pikët maksimale janë 25.</p> <p>Provimi me gojë konsiston në një prezantim të detajuar të projektit të kërkimit, të prezantuar nga kandidati si edhe certifikimin e njohurive në gjuhë të huaj.</p>



Shtohet shtojca nr. 3 bashkëngjitur kësaj rregulloreje si më poshtë:

Shtojca nr.3.

1. Punimi hartohet në gjuhën shqipe dhe një përmbledhje e tij (2000-4000 fjalë) hartohet në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian (*anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht*), në format të shtypur dhe elektronik. Përpara dorëzimit punimi miratohet nga udhëheqësi shkencor.

2. Punimi lidhet në pesë kopje origjinale. Në kapakun e përparmë të kopertinës të disertacionit, duhet të vendoset:

- stema e universitetit (në krye, në mes të kopertinës);
- emri i universitetit (në krye, në mes të kopertinës);
- emri i njësisë kryesore (në krye, në mes të kopertinës);
- emri i programit të doktoratës (në krye, në mes të kopertinës);
- fjala **DISERTACION** (në mes të kopertinës, Times Neë Roman, fonti i germës 20, Bold);
- **Për mbrojtjen e grades shkencore "Doktor"**
- **Titulli i disertacionit** (në mes të kopertinës, Times Neë Roman, font i germës 16, Centered, Bold);
- emri i kandidatit (në fund, në anën e majtë të kopertinës);
- emri dhe grada e udhëheqësit (në fund, në anën e djathtë të kopertinës);
- qyteti dhe viti i mbrojtjes (në fund, në mes të kopertinës).

3. Struktura e punimit shkencor ose disertacionit duhet të përbëhet nga këto pjesë kryesore:

- abstrakti;
- mirënjohja;
- tabela e përmbajtjes;
- lista e tabelave, figurave dhe grafikëve;
- studimi;
- hyrja;
- shqyrtimi i literaturës për fushën e kërkimit;
- qëllimi dhe metodologjia e studimit



- rezultate
- shqyrtimi i studimit kërkimor shkencor të realizuar nga doktoranti që reflekton dhe vlerësimin kritik pozitiv/negativ ndaj temës të trajtuar nga doktoranti;
- përfundime;
- bibliografia;
- shtojca.

4. Punimi duhet të respektojë kërkesat e formatit.

5. Nëse formati nuk prezantohet sipas formatit të kërkuar, ai nuk pranohet derisa të plotësohen të gjitha kërkesat e formatit.

6. Punimi shkencor ose disertacioni duhet të realizojë këto anë teknike:

- **Abstrakti.** Çdo punim duhet të përmbajë një abstrakt në shqip dhe në anglisht. Abstrakti duhet të përmbajë deri në 350 fjalë dhe do të jetë një përmbledhje që paraqet pikat kryesore dhe përfundimet e punimit. Abstrakti duhet të vendoset para falënderimeve dhe tabelës së përmbajtjes. Ky element duhet t'u mundësojë lexuesve vendas dhe të huaj të kuptojnë sesi është trajtuar çështja e marrë në studim. Abstrakti duhet të përmbajë jo më shumë se 5 (pesë) fjalë kyçe.
- **Mirënjohja.** Duhet paraqitur mirënjohja për të gjithë ata që kanë kontribuar në realizimin e punimit dhe financimin e tij.
- **Tabela e përmbajtjes.** Në këtë seksion paraqitet tabela e përmbajtjes me elementet e strukturës së punimit, shtojcat me titujt përkatës dhe numrin e faqeve për secilin element.
- **Lista e tabelave, figurave dhe grafikëve.** Në këtë seksion paraqitet lista e tabelave, e figurave dhe grafikëve të listuara me rend numerik siç janë paraqitur në disertacion bashkë me numrin e faqeve për secilin element.
- **Studimi.** Studimi, përgjithësisht, duhet të ketë këtë format:
 - **Hyrja.** Seksioni i hyrjes duhet të prezantojë fushën e studimit, çështjen e marrë në studim, detyrën shkencore, të përmbledhë informacionin e rëndësishëm dhe strukturën e punimit.
 - **Shqyrtimi i literaturës së fushës dhe të çështjes.** Në këtë pjesë paraqiten kontributet e identifikuara nga autorët e mëparshëm.
 - **Qëllimi dhe metodologjia e studimit.** Në këtë seksion paraqiten qëllimi, objektivat, hipotezat dhe metodologjia e studimit.
 - **Rezultatet.** Seksioni i rezultateve në një disertacion paraqet në mënyrë të strukturuar gjetjet e studimit, të ilustruara me tabela, figura, grafikë ose përshkrime në përputhje me qëllimin, objektivat dhe pyetjeve kërkimore të studimit.



- Shqyrtimi i studimit kërkimor shkencor të realizuar nga doktoranti që reflekton dhe vlerësimin e tij kritik pozitiv/negativ për temën e trajtuar;
- Ky seksion përmban seksionin e diskutimeve dhe shqyrtimin e materialit të mbledhur gjatë kërkimit dhe shprehjen e vlerësimit kritik pozitiv/negativ të doktorantit për temën e trajtuar me interpretime rreth tij.
- Përfundime. Ky seksion përmbledh gjetjet kryesore të studimit.
- Bibliografia. Të gjitha punimet shkencore duhet të përdorin literaturën dhe për citatat të tregojnë burimin e tyre. Seksioni i bibliografisë duhet të vendoset në faqe më vete.
- Shtojcat. Ky seksion përmban ilustrime shtesë, të dhëna e shifra origjinale që janë shumë të gjata për t'u përfshirë në tekst. Ato përfshihen në "Shtojca" në mënyrë që të mos e shkëpusin lexuesin nga diskutimet origjinale. Shtojcat mund të ndahen në seksione. Secila shtojcë ka titullin e vet dhe mund edhe të paraqitet veçmas në faqen e tabelës së përmbajtjes. Në këtë rubrikë përfshihen materiale të tilla plotësuese, si: instrumente të ndryshme të kërkimit të përdorura në studim, pyetësorë, intervista, harta, dokumente ligjore, historike, seri fotografish etj.
- Propozime të tjera. Ky seksion nuk është i detyrueshëm dhe kërkohet vetëm nëse rezultatet justifikojnë kërkimin e mëtejshëm.

5. Të gjithë kapitujt, çështjet, rubrikat e studimit renditen me rend numerik.

6. Lidhja. Pesë kopje të punimit shkencor duhet të lidhen. Njëra prej kopjeve duhet të jetë origjinalja. Në kopertinë duhet të vendoset emri i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", i Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, i programit, titulli i plotë i temës, emri i kandidatit, emri i udhëheqësit shkencor, viti i mbrojtjes,

7. Disertacioni shoqërohet me një përmbledhje rreth 2000-4000 fjalë gjuhën angleze. Përdoret madhësia 12-she e shkronjave. Ky element duhet t'u mundësojë lexuesve të kuptojnë sesi është trajtuar çështja e marrë në studim.

8. Fushën dhe fjalët kyçe. Studenti në bashkëpunim me udhëheqësin shkencor përcakton fushën dhe zgjedh fjalët kyçe në funksion të përshtatshmërisë së tyre me terminologjinë e përdorur në disiplinën përkatëse. Ato ndihmojnë identifikimin e tezës midis katalogëve kolektive në biblioteka.

9. Gjatësia e punimit. Pjesa e studimit shkencor për diplomën e gradës shkencore "Doktor" përcaktohet nga Komisioni i përhershëm (KP). Si rregull duhet të ketë jo më pak se 120 dhe jo më shumë se 160 faqe kompjuterike.

10. Vendi që zënë elementet e punimit:

- hyrja: 5 %;
- shqyrtimi i literaturës të fushës kërkimore shkencore: 35%;
- shqyrtimi i studimit kërkimor shkencor të realizuar nga doktoranti që reflekton dhe vlerësimin kritik pozitiv/negativ ndaj temës të trajtuar nga doktoranti: 50%;



- përfundime: 5%;
- bibliografia: 5%.

11. Për të llogaritur kufirin e fjalëve dhe të faqeve rekomandohet metoda e mëposhtme e llogaritjes:

- maksimumi 2310 karaktere për faqe për punimin e tezës;
- numri i karaktereve llogaritet duke përfshirë hapësirën, pikësimin në një radhë dhe shumëzohet me numrin e radhëve;
- në një radhë do të ketë 70 karaktere me një maksimum prej 33 radhësh.

12. Duhet përdorur letër e cilësisë së lartë, e bardhë, format A4.

13. Materiali duhet të shtypet vetëm nga njëra anë e letrës. Të gjitha kopjet e studimit duhet të jenë të shtypura me kompjuter, të printuara qartë dhe të jenë të lexueshme lehtësisht. Dorëshkrimet nuk pranohen.


14. Për shkrimin e disertacionit përdoret vetëm një lloj shkrimi. Lloji i shkrimit duhet të jetë Times New Roman. Masa e shkronjës duhet të jetë 12-she, formatimi justify, hapësirë ndërmjet rreshtave 1.5 (një pikë pesë), përveç rasteve kur në këtë Rregullore kërkohet ndryshe. Hapësira 1 (një) do të përdoret për përgatitjen e ekstrakteve, të shënimeve, të shpjegimeve të gjata dhe të listës së bibliografisë.

15. Numrat e faqeve. Të gjitha numrat e faqeve duhet të vendosen poshtë, në mes të faqes. Faqja e parë e kopertinës nuk duhet të numërohet.

- Hyrja duhet të ketë numra romakë.
- Pjesa e studimit duhet të ketë numra arabë.
- Faqet e bibliografisë, shtojcave duhet të numërohen me numra arabë në vijim të numrave të tekstit.

16. Tabelat e përfshira në tekst, duhet të vendosen në qendër të faqes, brenda margjinave të caktuara. Çdo tabelë i duhet vendosur një numër referimi me numër arab. Numërimi i tabelave në disertacion bëhet me numra të njëpasnjëshëm. Madhësia e shkrimit brenda tabelave duhet të jetë 10. Mbishkrimet e tabelave duhet të vendosen menjëherë para tabelës. Mbishkrimet duhet të paraprihen nga etiketa përkatëse, për shembull 'Tabela 1'. Ju lutemi përdorni vetëm një paragraf të vetëm për mbishkrimin. Sigurohuni që çdo tabelë të përmendet në tekst dhe në rend numerik. Nëse tabela vazhdon në faqen tjetër mbishkrimi nuk përsëritet. Si rregull, për fjalën "tabelë", mbishkrimin përdoret masa e shkronjës 12-she. Për shkrimin brenda tabelës përdoret hapësirë ndërmjet rreshtave 1 (një), justify, përveç rasteve kur zbatimi i këtyre elementëve teknikë, ndikon në paraqitjen vizuale të tabelës. Tabelat e mëdha që mbulojnë disa faqe mund të përfshihen në shtojcat si material plotësues.

17. Figurat, diagramat, fotografitë, ilustrimet dhe grafikët, duhet të vendosen në qendër të faqes, brenda margjinave të caktuara dhe të ofrohen me cilësinë më të lartë. Çdo figurë i duhet vendosur një numër referimi me numër arab. Numërimi i figurave në disertacion bëhet me numra të njëpasnjëshëm. Fjala "Figurë", numri i saj dhe emërtimi duhet të vendosen menjëherë pas figurës. Sigurohuni që çdo figurë të përmendet në tekst



dhe në rend numerik. Si rregull, për fjalën “figurë” dhe nënshkrimin e figurave, masa e shkronjës duhet të jetë 12-she dhe hapësira ndërmjet rreshtave 1 (një), justify, përveç rasteve kur zbatimi i këtyre elementëve teknikë, ndikon në paraqitjen vizuale të tyre. Përgjithësisht figurat, nuk duhet të kalojnë një faqe. Nëse ato vazhdojnë në faqen tjetër, duhet të ndiqet rregulli si për tabelat.

18. Studentët këshillohen të përdorin referenca të botimeve të ndryshme të fushës, të raporteve ose të disertacioneve të kandidatëve të suksesshëm, të cilat janë publikuar vitet e fundit, dhe mund të gjenden në biblioteka. Studenti në bashkëpunim me udhëheqësin shkencor vendosin për stilin e citimeve dhe referencave që do të përdorin. Madhësia e shkronjave të shënimeve është më e vogël se ajo e tekstit. Shënimet në fund të faqes (footnote), si dhe të gjitha llojet e tjera të shënimeve dhe referencave duhet të shkruhen me shkronja me madhësi 10-she.

19. Margjinat për të gjithë tekstin do të jenë:

- Margjina e sipërme: 1 “
- Margjina e poshtme: 1 “
- Margjina e majtë: 1.25 “
- Margjina e djathtë: 1.25 “



